



Pranuar / Dorezuar Punëhëno/Prodato Received/Delivered	22-12-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedimica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shënjë Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHEK	8371/2022		115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.937/2022**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.937/2022 të datës 21.10.2022, të parashtruar nga ankuesi, \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_

kundër Vendimit me numër protokolli: 27KA/2 të datës 19.09.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 21.12.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.937/2022 e datës 21.10.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokolli 27KA/2 i datës 19.09.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.
- III. Obligohet Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 21.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli \_\_\_\_\_

6358/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.937/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll: 27KA/2 të datës 19.09.2022 (të pranuar me datë 19.09.2022) të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me të cilin vendim ankuesit i është refuzuar si e pa bazuar ankesa e parashtruar kundër procedurës së gradimit për pozitën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, sipas Konkursit me numër reference MD/SHKK/006/01.06.2022 të datës 02.06.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 25.10.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa më datë 14.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit në pajtim me dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.11.2022 me Vendimin me numër VK.Nr.179/2022 ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune lidhur me ankesën A.nr.937/2022 e datës 21.10.2022.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 6358/2022 të datës 21.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokoll 27/KA të datës 09.09.2022 drejtuar nga ankuesi Komisionit për ankesa të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër protokoll 27KA/2022 të datës 19.09.2022 nga Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Lista e Rezultateve të vlerësimit të testit me shkrim për kandidatët që nuk e kanë kaluar testin me shkrim për pozitën Mbikëqyrës i Lartë; Konkursi me numër protokoll 622 të datës 02.06.2022 i shpallur nga Shërbimi Korrektues i Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoll 6445/2022 të datës 25.10.2022; Përgjigjen në ankesë të datës 27.10.2022; Kontratë Pune për kohë të pacaktuar të datës 15.07.2020 për ankuesin; Vendimin me numër protokoll 0529 të datës 11.05.2022 për caktimin e zëvendësuesit të Drejtorit të Drejtorit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në SHKK; Vendimin me numër protokoll 736 të datës 04.07.2022 për caktimin e zëvendësuesit të Zëvendës Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë; Vendimin me numër protokoll 0188 të datës 18.02.2022 për caktimin e zëvendësuesit të Udhëheqësit të Pavijonit në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë; Akt Emërimit të datës 07.06.2019 për Kontratë pune për kohë të pacaktuar të datës 27.06.2018 për Rekomandimin për përtëritjen e kontratës të datës 11.04.2018 për Kontratë Pune për kohë të pacaktuar të datës 30.06.2020 për Vendimin me numër protokoll 842 të datës 19.06.2019 për vazhdimin e ushtruesit të detyrës për Udhëheqës të Pavijonit në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë; Vendimin me numër protokoll 774 të datës 12.07.2022 për emërimin e komisionit përzgjedh për procesin e gradimit për mbikëqyrës i lartë dhe mbikëqyrës; Çelësin e testit me shkrim për pozitën Mbikëqyrës i Lartë; Lista e Zyrtareve që i kanë plotësuar kushtet për të ju nënshtruar testit me shkrim për pozitën Mbikëqyrës i Lartë; Lista e Rezultateve të vlerësimit të testit me shkrim e datës 19.08.2022; Lista e kandidatëve që kanë kaluar testin me shkrim për pozitën Mbikëqyrës i Lartë të datës 19.08.2022; Ftesë për intervistë me gojë për kandidatet që kanë kaluar testin për Mbikëqyrës të Lartë; Njoftimin e datës 23.08.2022; Listën e Rezultateve të vlerësimit të

intervistës me gojë për pozitën Mbikëqyrës i Lartë; Lista e Rezultateve të vlerësimit të intervistës me gojë për pozitën Mbikëqyrës i Lartë/Kandidati konsiderohet se ka kaluar testin e intervistës me gojë nëse ka arritur së paku 60 pikë; Listën e Rezultateve të renditjes përfundimtare të kandidateve për pozitën Mbikëqyrës i Lartë të testit me shkrim dhe intervistës; Testin me shkrim të ankuesit i datës 18.08.2022; Fletë kthesën të datës 30.09.2022; Plotësimi i Ankesës me numër protokolli 7092/2022 të datës 15.11.2022 nga ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e bazuar dhe se çështja duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës është vërtetuar se ankuesi sipas Kontratës së Punës për kohë të pacaktuar, të datës 15.07.2020, mban pozitën e punës Zyrtar Korrektues në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë – Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Kolegji i Këshillit duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 4, ku përcaktohet se: *1. Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë...* konstatoi se nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë si dhe ligjeve të veçanta lidhur me elementet e marrëdhënies së punës që kanë të bëjnë me: *kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve, dhe se Këshilli ka kompetence lëndore për trajtimin e kësaj çështje ankimore në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 dhe nenit 16 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Shërbimi Korrektues i Kosovës, më datë 02.06.2022 ka publikuar Konkursin për gradim me numër protokolli 629 për pozitën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, me numër reference MD/SHKK/006/01.06.2022, në të cilën pozitë ka aplikuar edhe ankuesi dhe si rrjedhojë ju kishte nënshtruar të gjitha fazave të procesit të gradimit, ku në testin me shkrim kishte rritur t'i mbledh 58 pikë, me ç' rast i njëjti nuk kishte arritur të kalonte me sukses pragun minimal prej 60 pikës, siç kërkohet me dispozitat e nenit 15 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD-NR.02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së Tyre, Periudha Provuese dhe Promovimi.

I pakënaqur me rezultatin e testit me shkrim, për pozitën përkatëse të punës, ankuesi brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 19 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së Tyre, Periudha Provuese dhe Promovim (me tej referuar si: Udhëzimi Administrativ MD-Nr.02/2022) ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa ky i fundit me datë 19.09.2022 me Vendimin më numër protokolli 27KH/2 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Kundër Vendimit më numër protokolli 27KH/2 të datës 19.09.2022 (të pranuar nga ankuesi me datë 30.09.2022) ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komisioni për Ankesa nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material sepse sipas të njëjtit testi me shkrim ka përmbajtur pyetje të formuluar gabimisht, duke ju referuar kështu pyetjes numër 44 ku përcaktohet se: *Cili është dallimi në mes të burgosurit dhe të paraburgosurit, ngase ankuesi pretendon se në këtë pyetje ka dhënë përgjigje të saktë, mirëpo për shkak se formulimi i pyetjes ka qenë gabimisht përgjigja e tij është vlerësuar me zero pikë nga Komisioni Përzgjedhës, dhe si rezultat i kësaj pyetje nuk ka arritur të kalojë testin me shkrim për të vazhduar me fazat tjera të rekrutimit, për çka i njëjti pretendon se Komisioni Përzgjedhës nuk ka qenë objektiv në vlerësimin e tij.*

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit analizoji aktin e goditur me ankesë, gjegjësisht Vendimin më numër protokoll 27KH/2 të datës 19.09.2022 të Komisionit për Ankesa në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe rrjedhimisht vlerësojë se i njëjti përmban të meta esenciale që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, kjo për faktin se me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 48 përcaktohet se: *1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, ndërsa me nenin 134 paragrafi 1 të të njëjtit ligj përcaktohet se: 1. Krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë, gjithashtu, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë.*

Kolegji i Këshillit ka gjetur se Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me rastin e shqyrtimit të ankesës nuk ka shqyrtuar pretendimin kryesor të ankuesit, i cili pretendim ka të bëjë me gabimet e supozuara në formulimin e pyetjeve në testin në shkrim, duke ju referuar kështu pyetjes se 44, ngase nga analizimi i aktit të goditur me ankesë Kolegji i Këshillit ka gjetur se i njëjti organ në aktin e kontestuar vetëm ka përshkruar gjendjen faktike, duke cituar se: *"Në pyetjen nr.44 të testit me shkrim, cili është dallimi në mes të burgosurit dhe të paraburgosurit, duke u bazuar sipas komisionit që kanë hartuar testin me shkrim (çelësi i testit) përgjigja e duhur është: I dënuari është i dënuar me vendim të formës së prerë, ndërsa i paraburgosuri është në pritje të aktgjykimit"* i cili arsyetim në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit është i pamjaftueshëm sepse nuk është dhënë sqarim i duhur nëse pyetja e 44 dhe përgjigja në çelësin e testit për pyetjen e njëjtë kishin kundërthënie mes veti, ngase ky ishte pretendimi kryesor i ankuesit.

Me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, përkatësisht neni 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ku përcaktohet se: *I burgosur nënkupton të gjithë personat e privuar nga liria të cilët gjenden në Institucionet Korrektuese, ndërsa me nenin 21 paragrafi 1 të këtij ligji përcaktohet se: 1. Shërbimi Korrektues me qëllim të ekzekutimit të sanksioneve penale si: dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm, dënimin me burgim për të mitur, masën edukuese korrektuese për të mitur si dhe masën e paraburgimit, përbëhet nga këto Institucione Korrektuese: 1.1. Qendrat Korrektuese; 1.2. Qendrat e Paraburgimit; 1.3. Institucionet e Sigurisë së Lartë, andaj, në vlerësimin*

e Kolegjit të Këshillit, organi i shkalles se parë duhet të ketë parasysh ketë dispozite ligjore, dhe si rrjedhojë të konstatoi nëse formulimi i pyetjes se 44 - të në testin me shkrim dhe përgjigja në çelësin e testit me shkrim të hartuara nga vet organi i punësimit kanë kundërthënie mes veti, dhe se ankuesi ka mundur të mos vlerësohet drejtë nga Komisioni Përzgjedhës, e të cilin pretendim ankimor Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave nuk e ka trajtuar fare, dhe ka dështuar ta vërtetoj si të tillë, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, duke qenë se vendimi i konstatuar, gjegjësisht Vendimi më numër protokolli 27KH/2 i datës 19.09.2022 i Komisionit për Ankesa pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që kjo çështja ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast të Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj ankesën e ankuesit dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh pikëpamjet juridike të dhëna nga Kolegji i Këshillit.

Kështu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** Lënda me numër A.nr.937/2022

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës



#### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

